

VENDIM
Nr.385, datë 19.6.2004

**PËR NJË NDRYSHIM E SHITESË NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESAT MBI PAGË TË
USHTARAKËVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë të pikës 1, fjalët e vendosura në kllapa “(drejtor drejtorie)” zëvendësohen me “(drejtor drejtorie në bazë, zëvendësdrejtor drejtorie në aparatin qendror dhe në drejtorinë e Tiranës)”.

b) Pas shkronjës “c” të pikës 2/1, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç. Këshilltar 80 000 lekë.”.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano